

## STATUTI

I

### SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

#### **LF Construction shpk**

Mbeshtetur ne ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregetaret dhe shoqerite Tregtare" neni 69, ne ligjin 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" nenet 26,28,32 dhe 35, Ortaket e Shoqerise:

1. Thanas Bakalli i biri i Vasil dhe i Triadha , lindur ne Leskovik Kolonje ne date 05.07.1969, banues ne Vrion Nd 445 Finiq Vrion 9716, mbajtes i letenjoftimit me nr ID G907051071
2. Faik Çumani i biri Abaz dhe i Shqiponja, lindur ne Vergo Sarande ne date 12.08.1985,banues ne Lagja nr 1 Nd 025 Sarande 9701, mbajtes i leternjoftimit me nr ID I50812086R

sot ne daten 17 tetor 2023 kane themeluar Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar :

**LF Construction shpk** e cila do te zhvilloje aktivitet tregetar ne Republiken e Shqiperise ,si dhe kane hartuar e firmosur kete statut te kesaj Shoqerie Tregtare, ne perputhje me dispozitat e mesiperme:

### 1. DISPOZITA TE PERGJITHSHME

#### Neni 1

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar **LF Construction shpk**, me kete statut ne perputhje me Aktin e Themelimit te Shoqerise dhe Legjislacionin Shqiptar ne fuqi, rregullon poziten juridike te ortakeve edhe Administratorit te Shoqerise, te punonjesve te saj, te dhenat me rendesi per poziten dhe qëllimin juridik, organizimin, aktivitetin financiar, objektin e veprimtarise te shoqerise dhe çështje te tjera me rendesi per punen e saj.

#### Neni 2

Shoqeria me Pergjegjsi te Kufizuar **LF Construction shpk** eshte krijuar nga Ortaket e Shoqerise

1. Thanas Bakalli i biri i Vasil dhe i Triadha , lindur ne Leskovik Kolonje ne date 05.07.1969, banues ne Vrion Nd 445 Finiq Vrion 9716, mbajtes i letenjoftimit me nr ID G907051071
2. Faik Çumani i biri Abaz dhe i Shqiponja, lindur ne Vergo Sarande ne date 12.08.1985,banues ne Lagja nr 1 Nd 025 Sarande 9701, mbajtes i leternjoftimit me nr ID I50812086R

me mjetet e tyre financiare dhe kane cilesine si Persona Juridik per regjistrimin ne Rregjistrin Tregtar.

Shoqeria ka vulen dhe logon e saj identifikuese ne formen dhe ne ekstremitetet e caktuara nga ortaket(ose nga asambleja e ortakeve)

#### Neni 3

1



Shoqeria e ka seline ne:

### **Sarande Lagja nr 1 Nd 025 Sarande 9701.**

Shoqeria ka te drejte te operoje me filjalet e saj ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise ose jashte vendit.

#### Neni 4

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise do te jete e pa kufizuar. Ky afat mund te ndryshohet me vendim te Ortakeve ne pajtim me Legjislacionin ne fuqi.

## **II. OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

#### Neni 5

Objekti I veprimtarise se Shoqerise **LF Construction shpk** do te jete:

Shoqeria ka si objekt te veprimtarise se saj:

1. Veprimtari ne fushen e ndertimit,shtrim me cemento goni,Ilustrim me helikopter,shtrime parketi,punime gipsi,veshje me kapot,lyerje me boje,punime karpentierie etj.
2. Ndertime civile dhe industriale.
3. Shitje me shumice dhe pakice te materialeve te ndertimit (hekur,cimento,tulla,pllaka,inerte etj
4. Import-eksport te artikujve ushqimore,si fruta, drithera,sheqer,pije alkolike dhe jo alkolike, etj.
5. Import-eksport te artikujve industriale, si makineri e pajisje, veglapune, pjese kembimi.
6. Prodhim, perpunim dhe amballazhim te artikujve ushqimore si fruta, drithera, pije alkolike dhe jo alkolike etj.Tregetimin e tyre me shumice dhe pakice.

#### Neni 6

Objekti i veprimtarise, Emertimi, Selia e Shoqerise, Shtimi i ortakeve dhe ato çka jane percaktuar ne kete Statut mund te ndryshojne me Vendim te Asamblese se Ortakeve ne perputhje me Legjislacionin ne fuqi.

#### Neni 7



Shoqeria ushtron veprimtarine e saj ne gjithe Territorin e Republikes se Shqiperise. Ajo mund te hapi filiale, dege e perfaqesi brenda e jashte vendit ne perputhje me Legjislacionin Shqiptar dhe te Vendit ku ajo do te ushtroje aktivitetin.

#### Neni 8

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj per te realizuar fitimin duke u mbeshtetur ne parimin e likuiditetit, sigurise e rentabilitetit dhe pergjigjet per detyrimet e veta me pasurine e saj.

### III. MJETET E SHOQERISE

#### Neni 9

*Kapitali themeltar I shoqerise eshte i perbere nga kontributi I ortakeve themelues me vleren 100,000 leke dhe perbehet teresisht nga kapitali para. Kapitali themeltar ndahet ne 2 kuota me vlere nominale respektivisht:*

1. Thanas Bakalli i biri i Vasil dhe i Triadha , lindur ne Leskovik Kolonje ne date 05.07.1969, banues ne Vrion Nd 445 Finiq Vrion 9716, mbajtes i leternjoftimit me nr ID G90705107I zoterues i 1 (nje) kuote me vlere nominale 50.000 (pesedhjete mije) leke e barabarte me 50% te kapitalit te shoqerise.
2. Faik Çumani i biri Abaz dhe i Shqiponja, lindur ne Vergo Sarande ne date 12.08.1985,banues ne Lagja nr 1 Nd 025 Sarande 9701, mbajtes i leternjoftimit me nr ID I50812086R zoterues i 1 (nje) kuote me vlere nominale 50.000 (pesedhjete mije) leke e barabarte me 50% te kapitalit te shoqerise

*Ne momentin e krijimit te shoqerise, Kapitali themeltar prej 100,000 leke eshte paguar teresisht nga ortakët themelues. Ne baze te kontributit te paguar pjesmarrja e ortakeve ne kapitalin themeltare eshte:*

- **Thanas Bakalli**                      **50 % te kuotave**
- **Faik Cumani**                        **50 % te kuotave**

*dhe eshte derdhur teresisht para firmosjes se statutit te shoqerise tregtare **LF Construction shpk.***

#### Neni 10

*Kapitali i shoqerise mund te shtohet me vendim te "Asamblese se ortakeve". Aktiviteti ne kete shoqeri nuk i pengon ortakët qe te kete te drejta pronesia dhe aktivitete jashte kesaj shoqerie. Kapitali i shoqerise mund te rritet sipas deshires se ortakeve dhe kushteve ne te cilat do ta ushtroje veprimtarine shoqeria.*

### IV .ADMINISTRIMI I SHOQERISE



#### Neni 11

Shoqëria zhvillon veprimtarinë e saj duke u bazuar në këtë Statut dhe në Ligjet në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

#### Neni 12

Shoqëria kryen veprimtarinë e vet me mjetet materiale e financiare të saj, si dhe mjete e kredi të akorduara në mënyrë të ligjshme. Ajo është e detyruar që vëllimin e punës së vet ta ushtrojë në vartësi të shumës së mjeteve të investuara dhe të shumës së mjeteve të rezervuara.

#### Neni 13

Shoqëria gëzon lirisht pronat dhe mjetet e saj financiare dhe ka të drejtë të ndryshojë ato në përputhje me objektin dhe qëllimin e veprimtarisë së saj.

#### Neni 14

Me Kapitalin Themeltar të Shoqërisë dhe me Kapitalin që mund të krijohet me vone Shoqëria mund të krijojë një fond të vecantë, i cili mund të mbetet në llogarë bankare të Shoqërisë.

Fondet monetare të Shoqërisë do të përdoren në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe Ligjet në fuqi.

#### Neni 15

Shoqëria do të çeli llogari në bankë, do të mbajë llogarë duke u mbështetur në Lekun Shqiptar, në EURO, USD e monedha të tjera të huaja, që janë në qarkullim. Veprimet bankare do të kryhen nga ana e Administrarorit.

#### Neni 16

Shoqëria do të ketë këto fonde: Fondin Themeltar, Fondin Rezerve e Fondin e Shperblimit. Për zhvillimin e veprimtarisë së vet Shoqëria mund të krijojë edhe fonde të tjera. Fondi Themeltar i Shoqërisë formohet nga Kapitali Themeltar si dhe Mjetet Teknike e Financiare që do të krijohen gjatë aktivitetit të saj.

#### Neni 17



Shoqeria shfrytezon Fondin Themeltar per ushtrimin e veprimtarise se vet, per investime te ndryshme ne fuksion te realizimit te qellimit te Shoqerise si dhe per te mbuluar rreziket pas shfrytezimit te Fondit Rezerve. Fondin Themeltar Shoqeria mund ta shfrytezoje edhe per destinacione te tjera te veprimtarise se saj.

#### Neni 18

Fondi Rezerve i Shoqerise formohet nga nje pjese e te ardhurave qe e realizon gjate veprimtarise se saj dhe qe percaktohet me nje vendim te veçante te asamblese se ortakeve. Fondi Rezerve shfrytezohe per te mbuluar humbjet dhe rreziket.

### **V.ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE**

#### Neni 19

Drejtuesi i Shoqerise do te jete **Z. Faik Cumani**, i cili eshte edhe Administrator i Shoqerise **LF Construction shpk** me nje afat prej 5 (pese) vjet

#### Neni 20

##### **Asambleja e Ortakeve** ushtron keto funksione:

Nxjerr planin dhe programin e veprimtarise se Shoqerise dhe aktet e pergjithshme, vendime per ndryshimin e emertimit te Shoqerise, per ndryshimin e selise se saj, te cilesise se saj, te objektit te veprimtarise, per shtim ortakesh dhe per ndryshim te Administrarorit. Vendos per rritjen ose pakesimin e Kapitalit Themeltar te Shoqerise, miraton Bilancin Vjetor dhe Raportin Financiar te Shoqerise, vendos per ndryshimin e formes se organizimit te Shoqerise, vendos per programin, strukturen dhe kohezgjatjen e veprimtarise se Shoqerise. Vendos per mbylljen e veprimtarise dhe caktimin e likujdatoreve. Te gjitha keto funksione do te kryhen ne perputhje me ligjin " Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", dhe "Per Sistemin e Taksave ne Republikën e Shqiperise" dhe ne respektim te akteve te tjera te legjislacionit Shqipetar.

#### Neni 21

##### **Administratori i Shoqerise ka keto detyra:**

Organizon e drejton punen dhe veprimtarine e Shoqerise. Perfaqeson shoqerine ne marredhenie me te tretet. Mban pergjegjesi per zbatimin e ligjeve ne Shoqeri si dhe per aktivitetin e saj. Pergatit aktet qe jane ne kopetence te Ortakut dhe kur krijohet asamble ortakesh atehere aktet jane kopetence e asamblese se ortakeve. Merret me organizimin dhe drejtimin e Shoqerise si dhe percakton strukturen, numrin, kualifikimin e punonjesve te Shoqerise, perfaqeson Shoqerine ne lidhjen e kontratave dhe kryen veprime te tjera juridike qe jane ne kopetence te Ortakut "te asamblese se ortakeve". Pergatit dokumentat per aplikimin per marrjen e lejeve te perpunimit e te shfrytezimit te

materialeve dhe te lendeve te para e ndihmese si dhe aplikon ne kontrata e tendera ku ka interes te marri pjese Shoqeria.

#### Neni 22

Ne mungese apo pamundesi te ushtrimit te funksionit te Administratorit ate e zevendeson nje ortak ose punonjes, qe caktohet nga ai vete me shkrim dheme prokure te posaçme.

### **VI. MENYRA DHE KUSHTET E PERDORIMIT TE FITIMIT.**

#### Neni 23

Pas perballimit te detyrave qe ka Shoqeria, taksave, tatimeve, pagave te punonjesve dhe shpenzimeve te tjera, fitimi neto i Shoqerise i perket Ortakeve te Shoqerise ne masen sipas % te kontributit.

### **VII. MARREDHENIET E PUNES DHE PERGJEGJESIA**

#### Neni 24

Marredheniet e punes ne Shoqeri rregullohen ne perputhje me Aktin e Themelimit, me kete Statut dhe Kodin e Punes te Republikes se Shqiperise. Shoqeria lidh kontrata per marrjen ne pune te punonjesve sipas Kodit te Punes.

#### Neni 25

Çdo punonjes ne Shoqeri eshte pergjegjes per kryerjen me profesionalizem dhe ndershmeri te punes. Ortaket, "Administratori" dhe punonjesit e Shoqerise jane te detyruar te ruajne karakterin e fshehte te dokumentacionit, informacionit dhe burimet e tij, njohurive e pervojes se fituar e shkëmbyer ne kuadrin e Shoqerise, fshehtesine e gjendjes financiare, depozitave e te dhena te tjera qe organi drejtues i Shoqerise i konsideron sekrete te punes. Te dhenat qe paraqesin sekrete te punes mund tu behen te njohura personave te tjere me lejen e Administratorit te Shoqerise. Detyrimi per ruajtjen e sekretit vazhdon edhe pas nderprerjes se marredhenieve te punes me Shoqerine.

### **VIII. MBYLLJA E SHOQERISE**

#### Neni 26

Ne qofte se humbjet e Shoqerise nuk mund te perballohen me mjete e Ortakeve te vena me rastin e themelimit te Shoqerise, ose me pas gjate veprimtarise se saj atehere hapet procedura e likujdimit te Shoqerise.

#### Neni 27

Shoqeria mund te shperndahet me likujdimin e saj. Ne rastin e likujdimit te Shoqerise emertimi i saj do te pasohet nga shenimi "Shoqeria ne likujdim e siper". Ne rast

shperndarje te Shoqerise, Administratori vendos per menyren e likujdimit, ndersa Ortaku ose "kur ekziston asambleja e ortakeve" cakton nje ose disa likujdatore, te cilet bejne kujdes qe Shoqeria te likujdoje detyrimet qe ka ndaj personave te trete.

#### Neni 28

Kur Shoqeria pushon aktivitetin e saj, pasi shlyen detyrimet qe ka, pjesa e mbetur e kapitalit dhe te ardhurat i mbetet Ortakeve, sipas raportit te kontributit ne Kapitalin Themeltar te Shoqerise.

#### Neni 29

Veprimtaria ekonomiko- financiare e Shoqerise mbyllet me 31 Dhjetor te çdo viti. Bilanci vjetor i Shoqerise duhet te shqyrtohet dhe miratohet nga asambleja e ortakeve gjate muajit Mars te vitit pasardhes.

#### Neni 30

Ne rast vdekje te ortakut pasuria u kalon ne pronesi trashegimtareve ligjore ne perputhje me depozitat ligjore per trashegimine.

#### Neni 31

Administratori i Shoqerise ka te drejte te emeroje avokate dhe ekonomiste si dhe t'u jape te drejta personave te tjere te veprojne ne emer dhe ne llogari te tij sipas ligjeve ne fuqi.

### IX. DISPOZITAT E FUNDIT

#### Neni 32

Shoqeria deklarohet e krijuar me regjistrimin e saj ne " Qendren Kombetare te regjistrimit QKR" , dhe ne Regjistrin Tregetar ". Nga kjo dite fiton **Statusin e Personit Juridik.**

#### Neni 33

Ndryshimet ne kete Statut behen ne te njejten menyre e procedure ne te cilen nxirret ky Statut duke zbatuar Dispozitat Ligjore perkatese.

#### Neni 34

Secili nga ortaket ka te drejte te largohet me deshiren e tij nga Shoqeria dhe ky largim mund te behet ne çdo kohe duke ndare dhe duke terhequr kapitalet qe i takojne ne forme monetare ,materiale ose asetesh mbi bazen e vleresimit dhe vendimit te marre nga asambleja e ortakeve.

#### Neni 35



Mosmarrveshjet ne Shoqeri do te zgjidhen me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet do te zgjidhen nepermjet Gjykates se Rrethit.


Sarande me, 17 Tetor 2023

**ORTAKET E SHOQERISE**  
**LF Construction shpk**

**Z. Thanas Bakalli**

Handwritten signature of Thanas Bakalli in blue ink, consisting of the name 'Thanas Bakalli' and a stylized initial 'TB' below it.

**Z. Faik Cumani**

Handwritten signature of Faik Cumani in blue ink, consisting of the name 'Faik Cumani' and a stylized initial 'FC' below it.